



Pranimar / Dorezuar Prilajeno / Protalato Received / Delivered	02.11.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSACK	6657/2022		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.249/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër AA.nr.422/2021, të datës 04.10.2022, të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.252/2018 të datës 30.04.2018 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komunës së Kaçanikut, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 02.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.252/2018 të datës 30.04.2018, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Komuna e Kaçanikut me datë 09.02.2018 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ultë "Jusuf Gërvalla", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi ndërsa sipas njoftimit të datës 06.03.2018 ishte përzgjedhur kandidat i suksesshëm

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 06.03.2018 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit me datë 22.03.2018 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në komunën e Kaçanikut, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i komunës së Kaçanikut, me datë 04.04.2018 merr vendim me numër 04-104/02-8860/18 me të cilin vendim refuzon si të pabazuar ankesën e ankuesit

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 04.04.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të komunës së Kaçanikut, më datë 30.04.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2394/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 28.06.2018 nxjerr Vendim me numër protokoll 3635/2018 me të cilin Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.252/2018 e datës 30.04.2018 e parashtruar nga ankuesi dhe Mbetet në Fuqi Vendimi i datës 04.04.2018 me numër protokoll 3635/2018.

Ankuesi, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 27.11.2018 ka paditur Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative për anulimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.252/2018 të datës 28.06.2018.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me datë 11.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.2804/18, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 01.04.2021 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar vendimin nr. 252/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 28.06.2018 dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 15.04.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit A.nr.2804/18 të datës 11.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore e Apelit e Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2804/2018 i datës 11.03.2021 vërtetohet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me nr. protokoll 2394/2018 të datës 30.04.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim AA.nr.422/2021 i datës 20.09.2022 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 04.10.2022 me numër protokoll 5852/2022; Fletë kthesë e datës 15.04.2021; Ankesë përmes përfaqësuesit të autorizuar të KPMSHCK për Gjykatën e Apelit të Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative me numër protokoll 1796/2021 e datës 15.04.2021; Autorizim me numër protokoll 1791/2021 i datës 15.04.2021; Aktgjykim A.nr.2804/18 i datës 11.03.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 01.04.2021 me numër protokoll 1572/2021; Procesverbal A.nr.2804/18 i datës 09.02.2021; Autorizim me numër protokoll 565/21 i datës 09.02.2021; Autorizim me numër protokoll 535/2021 i datës 08.02.2021; Aktvendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2804/18 i datës 14.12.2020; Padi e ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar e datës 27.11.2018; Përgjigje në padi me numër protokoll 91/2021 e datës 11.01.2021; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.252/2018 i datës 28.06.2018; Vendim me numër 55/2018 me numër protokoll 1958/2018 i datës 10.04.2018; Raport me numër V.nr.39/2018 me numër protokoll 1958/2018 i datës 10.04.2018; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 04.04.2018; Konkurs i Brendshëm

i datës 09.02.2018; Thirrje për shqyrtim kryesor e datës 29.01.2021; Fletë kthesë e datës 05.07.2018; Fletë kthesë e datës 05.07.2018; Fletë kthesë e datës 26.10.2018; E-mail nga H.H.G. për C.Z. i datës 07.10.2022; E-mail nga H.H.G. për C.Z. i datës 06.10.2022; E-mail nga C.Z. për H.H.G. i datës 06.10.2022; Akt Emërim i K.D. me numër 01.Nr.103/02-4601/18 i datës 15.04.2018; Vendim për emërim të përkohshëm i datës 14.04.2022; Vendim i Nivelit të Performancës së K.D. drejtor i shkollës "Jusuf Gërvalla" Biqec Kaçanik e datës 20.05.2022; Vendim me nr. protokolli 107/22 i datës 20.05.2022; Raport i vlerësimit të jashtëm të performancës së drejtorit/zëvendësdrejtorit të shkollës K.D. me nr. protokolli 105/22 i datës 19.05.2022; Raporti përmbledhës i vlerësimit të performancës së drejtorit/zëvendësdrejtorit të shkollës K.D. me nr. protokolli 106/22 i datës 19.05.2022; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar e K.D. me numër 01.Nr.103/02-4601/18 e datës 20.05.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit, është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar ankesën e ankuesit Nuredin Dullovi, me datën 06.10.2022 përmes e-mailit zyrtar, Këshilli ka kërkuar informata zyrtare prej Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Kaçanikut lidhur me atë se a është konsumuar mandati për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Jusuf Gërvalla" dhe të njëjtit a i është vazhdua mandati, ndërsa në përgjigjen zyrtare të datës 07.10.2022 përmes e-mailit zyrtar nga Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Kaçanikut e cila në Këshill është protokolluar me numër protokolli 5947/2022 me datë 07.10.2022, kjo e fundit ka deklaruar se: *"Lidhur me kërkesën e juaj ju njoftojmë se pas skadimit të kontratës së punës së Pas vendimit të inspektoratit të arsimit kemi qenë të obliguar t'i vazhdohet kontrata e punës në afat prej një (1) viti"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës, konstaton se objekti i shqyrtimit të ankesës së ankuesit është bërë i pamundur ose i kotë, pasi që në bazë të Akt Emërimit me numër 01.Nr.103/02-4601/18 i datës 15.04.2018, kandidati i suksesshëm Kemal Dullovi ka qenë i emëruar qenë me mandat 4 (katër) vjeçar, prej datës 15.04.2018 deri 14.04.2022 e që rrjedhimisht të njëjtit i ka përfunduar mandati i Drejtorit në Shkollën Fillore të Mesme të Ultë "Jusuf Gërvalla" të fituar sipas konkursit të kontestuar, andaj në pajtim me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, meqenëse ka konstatuar se objekti i shqyrtimit kundër të cilit ka filluar kontesti në procedurë administrative përmes ankesës së ankuesit të datës 30.04.2018, është bërë i pamundur apo i kotë gjegjësisht ka vendosur të bëjë përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e ankuesit të datës 30.04.2018, ngase në konkursin i cili është kontestuar përmes kësaj ankese, është përzgjedhur kandidati i suksesshëm i cili sipas akt emërimit me numër 01.Nr.103/02-4601/18 të datës 15.04.2018 ka qenë me emërim të përkohshëm në kohëzgjatje prej datës 15.04.2018 deri 14.04.2022, rrjedhimisht afati i emërimit sipas akt të emërimit ka përfunduar.



Andaj, bazuar në këto rrethana dhe konstatimeve të dhëna si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragraf 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.249/2021.

Çlirim ZEKA

Çlirim ZEKA
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kaçanikut;
- Udhëheqësitë të Personelit në Komunën e Kaçanikut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

